

RITHIRRJE PËR APLIKIM PËR POZICIONIN VAKANT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË “PORTI DETAR SHËNGJIN” SH.A

Bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 03.10.2018 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Tregtare Shtetërore”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, Urdhërit të Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 133, datë 26.09.2025 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës për shpalljen dhe përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive tregtare strategjike dhe jostrategjike të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, Ministria rishpall procedurën për plotësimin e 1 (një) pozicioni vakant në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë “Porti Detar Shëngjin”, Sh.a.

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të zotërojë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- d) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- e) të mos ketë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;
- ë) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- f) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

Kandidati që aplikon për anëtar në Këshillin Mbikëqyrës, në përmbushje të kriterëve ligjore, paraqet pranë Ministrisë dokumentacionin si vijon:

- kopje të dokumentetit të identifikimit;
- jetëshkrimin;
- kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vjet akademikë;
- vërtetim që për të nuk është marrë masë disiplinore për largim nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- kopje të librezës së punës të njehsuar me origjinalin;
- dëshmi penaliteti (në rast të mos sigurimit të saj në kohë të depozitohet dokumentacion provues që është aplikuar për marrjen e këtij dokumenti);
- vërtetim mjekësor që është i aftë për punë (në rast mos sigurimit në kohë të depozitohet dokumentacion provues që është aplikuar për marrjen e këtij dokumenti);
- vetëdeklarim se nuk gjendet në konflikt interesi me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, bëhet në zyrën e Arkiv-Protokollit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, nga data **16.12.2025-22.12.2025**.

Përzgjedhja e kandidatit për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Porti Detar Shëngjin”, sh.a zhvillohet në dy faza.

Faza e parë: Verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga Kandidatët, e cila realizohet nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Nëse struktura përgjegjëse për burimet njerëzore konstaton se dokumentacioni i paraqitur ka mangësi, e njofton kandidatin në rrugë elektronike për plotësimin e tyre brenda një afati prej 2 (dy) ditë-pune. Kandidatët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen. Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore harton listën me kandidatët që plotësojnë kërkesat ligjore dhe ia përcjellë atë Ministrit.

Faza e dytë: Ministri përzgjedh kandidatët fitues nga lista e paraqitur nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore.

Komunikimi me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresës së e-mail.